



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:152811
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05602888

C.nr.346/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Fëllanza Knushaj dhe me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses D.A-H., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Sylejman Klinaku, avokat në Prishtinë në avokaturën “Klinaku & Associates” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar T.V., për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 6,090.93 euro, jashtë seance me datë 22.04.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses D.A-H., nga Gjakova me të cilën ka kërkuar që të *“APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses së lartcekur dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses të lartcekur në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë nga data 18.04.2017 deri me 22.01.2021, dhe 10% të një page bazë nga data 22.01.2021 deri në përpilimin e ekspertizës nga ana e ekspertit financiar, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e shkaktimit të dëmit, gjerë në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.”*

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja D.A.H., nga Gjakova në këtë gjykatë me datë 27.07.2022, përmes të autorizuarit të saj Sylejman Klinaku, avokat në Prishtinë në avokaturën “Klinaku & Associates” me seli në Prishtinë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit,

duke theksuar se paditësja është e punësuar si mësimdhënëse në SHMLT “...” në Gjakovë. E njëjta ka të kryer fakultetin e inxhinierisë elektrike nga ku ka marrë titullin inxhinier i diplomuar i elektroteknikes, e po ashtu është e licencuar nga MASHT. Ka kërkuar që në emër të kualifikimit të i paguhet shuma përkatëse me kamatë ligjore, si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale. I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datës 24.10.2023, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar që të i paguhet diferenca në pagë nga data 18.04.2017 deri me datë 31.12.2022 shuma prej 6,090.93 euro, ka kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarit të tij T.V., në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 06.09.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditëses nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësja dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Po ashtu, paditëses nuk i takon ky kompensim as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parashih që punëtorëve të arsimit iu takon kompensimi i tillë, prandaj kërkesës së paditëses i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësja nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Po ashtu i njëjti është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazë dhe si e tillë u refuzua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen D.A-H., e lëshuar nga Komuna e Gjakovës– Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “...” – Gjakovë, si mësimdhënëse e lëndës së elektroteknikës. Si dhe nga vertetimi mbi përvojën e punës i lëshuar nga SHMLT “...” në Gjakovë, me nr. 3640 i datës 14.03.2022, paditësja ka filluar punën me datë 18.10.2021. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet fakti se paditësja realizon pagë bazë në lartësi prej 459.00 euro dhe në emër të kualifikimit për çdo muaj për vitet 2021 dhe 2022 i është paguar shuma prej 63.68 euro. E njëjta ka diplomuar me datë 19.07.2007 dhe ka marrë kualifikimin ingjnier i diplomuar i elektroteknikes fakt që vërtetohet përmes Diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike, me numër 318 e lëshuar me datë 20.11.2007. Po ashtu paditësja ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 100009463. Gjykata konform nenit 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të*

kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”, provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkatësisht refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses për shkak se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga kontrata e punës për paditësen rezulton se njëjta punën si mësimdhënëse e lëndëve të elektroteknikës në SHMLT “...” e ka filluar me datën 18.10.2021. Po ashtu e njëjta datë e fillimit të punës përkon edhe me vërtetimin për përvojën e punës të lëshuar nga administrata e shkollës së lartcekur, në të cilën është cekur se paditësja ka përvojë punë duke filluar nga data 18.10.2021 ku edhe vazhdon të punoj. Gjykata vlerëson se paditësja me asnjë provë nuk e ka provuar se ka qenë në marrëdhënie pune me të paditurën për periudhën kohore kontestuese, përkatësisht para datës 18.10.2021, siç parashihet me nenin 7 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet se “*Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova më të cilat konstatohen faktet e tilla.*”

Ndërsa sa i përket pjesës tjetër të kërkesëpadisë dhe atë për periudhën kohore nga data 18.10.2021 deri me datë 31.12.2022, të njëjtën gjykata e refuzoi për shkak se paditësja përmes të autorizuarit të saj, me parashtresën për precizimin e kërkesëpadisë ka kërkuar që për këtë periudhë kohore të i kompensohet shtesa prej 10% në pagë, përkatësisht shuma prej 45.00 euro në muaj, mirëpo nga provat që gjenden në shkresat e lëndës përkatësisht listat e pagave për vitin 2021 dhe vitin 2022, gjykata ka vërtetuar se në këtë periudhë kohore të njëjtës i është paguar për çdo muaj shuma prej nga 63.68 euro në emër të kualifikimit. Gjykata edhe pse vërtetoi se paditëses i takon kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit në lartësi prej 27% të pagës bazë, në rastin konkret veprimi brenda kufijve të kërkesës që janë parashtruar nga paditësja konform nenit 2 par.1 të LPK-së dhe erdhi në përfundim se e paditura ka realizuar në tërësi kërkesën e paditëses.

Andaj, nga këto arsye, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “*Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura*”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, gjykata e morri sipas nenit 450 të LPK-së.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.346/22, 22.04.2024

Gj y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.